



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
OIK

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
Oda e Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës Kosova medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals	
ARKIV ARHIV ARCHIVE	
Nr. Prot. 144	Nr. i faq. -2-
Broj. prot.	Br. str.
Prot. no	No. page.
Data: 01.03.2022	
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Në bazë të Nenit 21 dhe 39 të Ligjit Nr. 04/L-150, dhe Nenit 41. paragrafi 1.2 të Statutit të përhershëm të Odës së Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Republikës të Kosovës, Kuvendi i OIK në mbledhjen e mbajtur më datën 26.02.2022 miratoi:

V E N D I M

Për ndryshim dhe plotësim të vendimit me nr prot. 29 të dates 15.05.2017 për lartësinë e të hyrave dhe taksave administrative

1. Të gjithë anëtarët e OIK-ut pas regjistrimit në librin e regjistrimit të anëtarëve janë të obliguar të paguajnë anëtarësinë në baza mujore, në lartësinë prej:

1.1 Infermierët dhe profesionistët tjerë të punësuar në sektorin publik edhe privat paguajnë anëtarësinë në baza mujore në lartësinë prej 0.5 % nga paga bazë (Bruto).

1.2 Ndërsa Infermierët Mamit dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë që punojnë në sektorët privat duhet të paguajnë ndalesë vjetore në bazë të Kontrates së punës të lëshuarë nga Institucioni ku punon dhe kjo ndalesë vjetore gjithashtu duhet të ndalet nga 0.5% në pagën Bruto.

1.3 Infermieret e regjistruar në regjistrin e OIK të cilët nuk janë në marrëdhënie pune paguajnë shumë paushallë në shumën fikse prej 50 € për 5 vite .

2. Në emër të taksës administrative për licencim të gjithë anëtarët e OIK paguajnë taksën në lartësinë prej:

- Për licencim të anëtarëve të OIK përgaditje të lartë (bachelor dhe master) 60 Euro
- Për licencim të anëtarëve të OIK me përgaditje të mesme shkollore 30 Euro

3. Në emër të taksës administrative për ri-licencim të gjithë anëtarët e OIK paguajnë taksën në lartësinë prej:

- Për licencim të anëtarëve të OIK përgaditje të lartë (bachelor dhe master) 40 Euro
- Për licencim të anëtarëve të OIK me përgaditje të mesme shkollore 30 Euro

4. Për dokumente dhe shkresa administrative paguhet taksa administrative në lartësinë prej:

- Për dokumente dhe certifikata në përdorim jasht vendit lartësia e pagesës është 10 Euro.
- Për dokumente dhe certifikata në përdorim të brendshëm, lartësia e pagesës është 2 Euro.

5. Pagesa e anëtarësisë dhe taksave bëhet në xhirollogarinë e veçant të OIK.

6. Të gjithë profesionistët shëndetësorë që nuk i kryejn obligimet nga pika 1, 2 dhe 3 dhe kanë ngecje 6 muaj do të shlyhen nga regjistri i anëtarësisë së OIK, dhe do ti revokohet licenca e punës.

7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i OIK dhe nënshkrimit nga Kryetari i OIK.

Do të zbatohet deri në miratimin e rregullorës së veçantë.

Prishtinë, 26.02.2022



MA. BSc. Naser Krustemaj

Kryetar i OIK
Presednik KKS
Head of KNCh